

**Z. Besmir Pajaj**, ka kryer studimet e larta për Drejtësi, në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, në periudhën 2005-2009. Në vijim ka përfunduar studimet edhe për Financë – Kontabilitet në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” Elbasan. Në vitin 2012, ka përfunduar programet e studimit “Master Profesional në Administrim Publik” në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, Fakulteti i Shkencave-Politike Juridike.

Z. Pajaj ka një eksperiencë pune prej rreth 14 vite, nga të cilat 1 vit në sektorin privat, 3 vite në Administratën Publike, ndërsa në Kontrollin e Lartë të Shtetit ka mbi 10 vite eksperiencë.

- Në periudhën Dhjetor 2010 - Nëntor 2013 ka punuar në Ministrinë e Drejtësisë/Drejtoria e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve.

- Në vitin akademik 2011- 2012 është angazhuar si pedagog lektor (part-time), në Fakultetin Shkencave Politike Juridike në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, për lëndët “Kriminalistikë”, “Filozofi e së drejtës” dhe “E drejtë mjedisi”.

- Nga muaji Mars 2014 deri në shtator 2024 ka ushtruar detyrën e audituesit në departamentet e auditimit në KLSH dhe të Kryeaudituesit në Departamentin e Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja. Aktualisht është i emëruar në pozicionin e “Drejtorit të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm”.

- Në Qershor 2012 është certifikuar si “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik”.

- Në Tetor 2010 ka fituar titullin “Avokat”.

- Në Korrik 2013 është pajisur me Licencën e “Ndërmjetësit”.

- Në Dhjetor 2021 është pajisur me Licencën Profesionale për “Vlerësimin e Pasurive të Paluajtshme”.

Gjatë karrierës së tij profesionale ka marrë pjesë në trajnime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit si për luftën kundër pastrimit të parave, diagnostikimin dhe menaxhimin e rrezikut të korrupsionit në prokurimet publike etj. Gjithashtu, në vijimësi ka marrë pjesë në trajnime, konferenca, seminare, të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, në lidhje me çështje të auditimit të jashtëm publik.

Z. Pajaj është njohës i gjuhës angleze dhe italiane.